

Itali/ Memushaj shenon dhe fitoren derbin me Ujkanin

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 21 Dhjetor 2013 23:13



Ne Serine B italiane ka patur nje derbi shqiptaresh. Ledian Memushaj me Carpin e tij ka mundur Palermon e Saimir Ujkanit. Kete perballje e ka fituar mesfushori vlonjat qe nga pika e bardhe e penalltise ka fituar golin e vetem te takimit dhe te fitores per skuadren e Carpit. Ne kete takim sulmuesi Edgar Cani nuk ka luajtur asnje minute ndersa Memeshaj dhe Ujkani kane zhvilluar derbin e tyre. Per sulmuesin e kombetares, largimi nga skuadra italiane duket i afert pasi ai nuk ka gjetur aspak hapësira aktivizimi ndersa per Memushaj po interesohen disa skuadra italiane te Serise B dhe asaj A.